

Në bazë të nenit 2 dhe 10 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049,nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit,Kuvendi i komunës së Dragashit në seancën e mbajtur më 31.10.2008 miraton këtë:

R R E G U L L O R E
M B I D H Ë N J E N E L E J E S P Ë R U S H T R I M I N E V E P R I M T A R I S Ë A F A R I S T E D H E
P R O F E S I O N A L E

Neni 1

1.1.Me kete Rregullore caktohen kushtet dhe lartësia e takses për leje pune për ushtrimin e veprimtarisë afariste ne teritorin e komunës së Dragashit.

Neni 2.

2.1.Të gjitha shoqëritë tregtare – bizneset të cilat tashmë janë të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës janë të obliguara që të marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste në lokalet të cilat ndodhen brenda teritorit të komunës.

2.2.Me leje për ushtrimin e veprimtarisë nga paragrafi 1 i nenit 2 duhet të paisen edhe bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari profesionale “leja për sherbime profesionale” si kontabilist,mjek,stomatolog,avokat,sherbime të përkethimit dhe shtypjes,sherbimet e ndryshme profesionale.

Neni 3.

3.1.Taksa për leje per ushtrimin e veprimtarisë (tregtare,zajtare ,hoteliere dhe sherbimeve profesionale paguhet per secilin lokacion ku ushtrohet nji veprimtari afariste brenda kufijve të komunës.

3.2.Nese nji shoqëri tregtare dhe bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari profesionale,ushtrojnë veprimtari afarise në më shum se nji lokacion në teritorin e komunës,atëher për sejcilin lokacion ku ushtrohet veprimtaria duhet të marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 4

4.1.Para dhënies së lejes per ushtrimin e veprimtarisë afariste bizneset janë të obliguara që organit kompetent për dhënien e lejeve ti paraqesin argumentet se biznesi është i regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës,

4.2. Provën me të cilin subjekti afarist e dëshmon pronësinë e lokalit afarist,ose kontratën e vertetuar nga ana e Gjykates kompetente per marrjen me qira te objektit afarist,

4.3. Pëlqimin e leshuar nga komisioni kompetent të cilin e formon Drejtorati për Financa,Ekonomi dhe zhvillim mbi vertetimin e faktit se objekti afarist per ushtrimin e veprimtarise afariste i ploteson kushtet minimale higjeno-teknike dhe sanitare si dhe kushtet e mbrojtjes në punë,

4.3 Deshmin mbi pagesen e takses per leje pune , dhe

4.4 Deshminë mbi përmbushjen e obligimeve ligjore (tatimi ne pronë,taksa komunale të lëshuara nga Zyra e Administrates Tatimore pranë KK Dragashit) dhe obligimeve kontraktuese.

Neni 5

5.1.Organi komptent komunal per regjistrimin e bineseve ,është i obliguar që pas shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar nga neni 4 i kesaj Rregulloreje të lëshoj lejen e punës për ushtrimin e veprimtarisë.

5.2.Leja e leshuar nga neni 5.1. i kësaj rregullore duhet të precizojë objektin e veprimtarisë të subjektit ,vendin – selinë e ushtrimit të veprimtarisë,afatin e vlefshmerisë të lejes .

Neni 6

6.1. Leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe profesionale e leshuar në pajtim me nenin 5 të kësaj Rregulloreje ka afatin e vlefshmerisë prej 5 vitesh, nga data e leshuarjes .

Neni 7

7.1. Leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe ushtrimin e veprimtarive profesionale duhet të ekspozohet publikisht në lokacionin për të cilin është dhënë leja.

7.2. Komuna përmes organeve të mbikqyrjes nuk do të lejojë asnjë ndërmarrje –biznesi e cila nuk është e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës që të ushtrojë veprimtari afariste brenda komunës, përveç nëse deshmohet se janë të liruara nga ky regjistrim.

Neni 8

8.1. Për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste caktohet taksa sipas kategorisë së veprimtarisë afariste (psh shitja me shumicë, shitja me pakicë, zëjtari, hoteliri dhe shërbime hoteliere), dhe sipas llojit të shërbimeve profesionale .

8.2. Taksa për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste sipas par. 8.1. të këtij neni është e përcaktuar në tarifen mbi llojin e ushtrimit të veprimtarisë dhe lartësinë e taksës skema tarifore.

KATEGORIA I

1. Industria e përpunimit të metaleve, ngjyrosjes, përpunimit të ushqimit, minierat, gurthyesit (rëra dhe gurët që përdoren për meremetimin dhe riparimin e rrugëve), Ndermarrjet shoqërore dhe publike, PTK dhe rrjeti kabllovik me internet..... 200,00 €

2. Për njësi 50% nga baza fillestare.

KATEGORIA II

3. Kompanit tregtare për shitjen me shumicë, ndërmarrjet prodhuese, ndërtimore dhe projekteve si dhe ato për tregti me shumicë të mallrave, tregtia komisionare, ndërmarrjet grafike botuese dhe shoqërit me përgjegjësi të kufizuara 200,00 €

4. Për njësi 50%

KATEGORIA III

5. Hotelet, DPT si dhe supermarketet, veshërbimet (mbi 60 m²)

Këmbimoret e mjeteve financiare dhe bizneset për dërgimin e të hollave, Pompat e benzinës..... 150,00 €

KATEGORIA IV

6. Filijalat e kompanive të sigurimit, Kompanit e transportit të mallrave dhe udhëtarëve, mulliset, mishtoret, barnatoret farmaceutike, restaurantet në të cilat shërbehet alkoholi dhe ushqimet e përgaditura, objektet rekreative sportive, minimarketet, autosallonet dhe argjentarët.... 100,00 €

KATEGORIA V

7. Restaurantet (pa pije alkoholike dhe ushqim) me pije freskuese, Ordinancat mjeksore private, ndërmarrjet tregtare private me pakicë, transporti publik, ndërmarrjet e shërbimeve publike, Zdrukthtaria (punimi i dyerve nga druri, plastika alumini dhe shitja e tyre), agjensit e udhëtimit, veterinarit dhe Ndërmarrjet ndërtimore private..... 100,00 €

KATEGORIA VI

8. Radistacionet private, autoshkollat, bastoret, pishinat, bukë pjeksit, byffet, disko bare, avokatët, qendrat diagnostike dhe Institucionet private të arsimit 100,00 €

Kategoria VII

9. Dyqanet e pavarura tregtare (qëndra) pa marr parsysh veprimtarit e tyre, kafe qajtoret, qebaptoret, kafebar, internet cafe, gjellbërës, barnatore bujqësore, përpunues të llamarinës-teneqe punues, automekanik, kontabilist, teknik të dhëmbëve, laborator, autotranspotus mbi 3,5 tonelata dhe Minifermat..... 75,00 €

Kategoria VIII

10. DPT (pamarr parsysh veprimtarin e tyre) qebaptoret , kafe qajtoret,frizeret për mashkuj dhe femra,byrektoret,xhamprersit, DPT në shtangje dhe treg 60,00 €

Kategoria IX

11. Profilimi në të ftoftë,gomisteri,autolarje,riparuesit e aparateve të amvisnisë,vullkanizerët,parkingjet e automjeteve,lojrat zbavitse,video klubet e kasetave,fotografët dhe DPT të cilët veprimtarin e zhvillojn në viset rurale-fshat..... 40,00€

Kategoria X

12. Kiosqet në qytet dhe fshat,biciklistët,ortarët,rrobaqepsit,farkëtarët,shitsit e hamburgerave ne kiosqe,arnuesit e veshmbathjës,fotokopjusit,vulëpunuesit , taxit,blurësit e kafës dhe tregtarët lëvizës..... 25,00 €

13.VËREJTJE: Të gjitha ato veprimtari të cilat nuk jan cekur hyjn në Kategorin e X.

Neni 9

9.1.Çdo ndryshim që ka të bëjë me afarizmin e subjektit afarist duhet lajmërohet te organi kompetent i cilli e ka dhene lejen per ushtrimin e veprimtarisë me qellim evidentimi në regjister te veprimtarive afariste dhe profesionale.

9.2.Organi kompetent për dhenjen e lejeve per ushtrimin e veprimtarise afariste është i Obliguar qe menjherë ti evidentojë në regjister të gjitha ndryshimet e kerkuara , nëse për këtë egziston arsyesheria .

Neni 10

10.1.Leja per ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe profesionale humb vlerën kur:

a) vdesë apo humb zotësinë për te vepruar mbajtësi i saj,

b) mbaron afati i dhënjes së lejes.

Neni 11

11.1.Leja per ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe profesionale hiqet nga organi që e ka lëshua atë kur:

a) kerkohet nga mbajtësi i saj,

b) mbajtësi i lejes nuk i përmbush detyrimet e pëcaktuara me ligjë (detyrimet ligjore dhe kontraktuese).

Neni 12

12.1.Leja mbi ushtrimin e veprimtarisë afariste nuk mund të bartet ne personin tjetër-është e pa tjetersueshme.

Neni 13

13.1.Mbi zbatimin e kesaj Rregullore do të kujdeset Drejtorati per Financa,Ekonomi dhe Zhvillim – Njisia per dhenjen e lejeve per ushtrimin e veprimtarive afariste dhe organet kompetente për punë të inspekcionit.

Neni 14

14.1.Kjo Rregullore shfuqizon Vendimin mbi Licencimin e Subjeteve Afariste.

Neni 15

15.1.Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit të saj në Kuvend,ndersa do të implementohet nga 01.01.2009.

01 Nr.06-144/1
Dragash,31.10.2008

KRYESUESI I KUVENDIT
Lulzim Rifaj

